



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN**  
**DREJTORATI I INSPEKTORATIT**



**DREJTORATI I INSPEKSIONIT**

<b>Datë :</b>	<b>04.08.2023</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/8</b>
<b>Për :</b>	<b>Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës</b>
<b>Nga:</b>	<b>Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit</b>
<b>Lënda :</b>	<b>Raporti i muajit-gusht</b>

## **PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

Gjatë muajit gusht Drejtoria e Inspektoratit ka realizuar inspektime të ndryshme, duke përfshirë të gjitha lokalitetet.

Inspektorët e tregut- kanë bërë inspektime të subjekteve të ndryshme afariste të cilat nuk janë të regjistruara në ARKB si dhe biznese të cilët nuk kanë pranime teknike. Të gjitha këto biznese janë urdhëruar me procesverbal të bëjnë regjistrimin në ARBK dhe të aplikojnë për pranim teknik të lokalit afarist.

Inspektim i bizneseve është bërë lidhur me vendosjen çmimeve, krahasimin e çmimeve raft-arkë, vendosja e flamujve se nga është origjina e mallit. Në bizneset ku nuk ka qenë çmimi i njëjtë raft-arkë është iniciuar procedurë kundevajtëse.

Edhe gjatë këtij muaji inspektorët e tregut kanë inspektuar në sheshin "Adem Jashari" dhe në rrugët kryesore të qytetit ku janë larguar shitës ambulancë, të cilët realizonin aktivitetin e tyre pa pasur pëlqim nga organet kompetente komunale, ndaj shitësve të cilët nuk kanë respektuar urdhëresat e dhëna nga inspektorët janë shqiptuar gjopa mandatore.

Janë menaxhuar tregjet: tregu i gjelbër, tregu i mobileve, si dhe tregu i kafshëve.

Inspektori i mjedisit-ambientit- është përgjigjur ankesave të qytetarëve. Ankesa kemi pasur nga qytetar të ndryshëm nga lokalitet. Ankesat kanë qenë kryesisht për problemet e kanalizimit, ujërave atmosferik.

Është bërë kontroll i investitorëve të objekteve shumë banesore në rr. "Sadik Shala" dhe në rrugën "Enver Olluri" në Lipjan ku janë dhënë urdhëresat për respektim të kushteve të lejes mjedisore komunale, grumbullimin e mbeturinave në kontejner dhe dorëzimi i tyre të bëhet në kompaninë e Pastrimit.

Janë kontrolluar disa deponi të egra të mbeturinave në fshatrat: Gadime Ulët dhe e Lart, Varigovc, Shalë, Sllovi, Qylag, Krojmir, Bincë.

Inspektorët e trafikut- Objektivë e inspektoreve të trafikut ka qenë inspektimi i kompanive të autobusëve, auto-taksive si dhe kombi-taksi ilegal.

Në muajit gusht është bërë inspektimi në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" me objektivë kontrolli i kompanive radio-taksiv të cilat kompani posedonin licence dhe i përmhashin licencës. Gjithashtu, inspektorët e trafikut janë marrur proceduralisht me personat të cilët kanë bërë prerje të asfaltit në rrugë dhe trotuareve në qytet dhe fshatra, për shkak të kyçjes në rrjet të kanalizimit dhe ujësjellësit.

Inspektori i ndërtimit- Periudhë kohore në të cilën janë realizuar ndërtime me ritëm të lartë. Janë inspektuar e konstatuar me procesverbal objekte me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi. Për secilin rast janë ndjekur hapat procedural ligjore, ndalimi i ndërtimit, si dhe dy vendosje të shiritave zyrtar. Vendosja e shiritave zyrtar është bërë në Magurë në një objekt të braktisur pronë e AKP-së, ku është njoftuar AKP- ja, si dhe në fashitin Gadime në një gropë të vet hapur.

Pra, nga inspektorët e ndërtimit janë realizu, procesverbale, fletëparaqitje dhe vendosje të shiritave, si dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjigjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët.

## **PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE**

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit gusht janë:

Janë inspektuar lokalet afariste, marketet ku janë kontrolluar çmimet e artikujve ushqimor në rafta dhe çmimet e arkës gjatë pagesës.

Largimi i shitësve ambulat pa pëlqim nga Sheshi “Adem Jashari” dhe rrugët e qytetit.

Ndalimi i tregtimit në rrugët e qytetit.

Shqiptimi i gjobave mandatore..

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

## STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Objekte te legalizuar	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuara	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygesore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Ispektim i biznesweve pa pranime teknike	Menaxhim I tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	166	27	12	1					51	15			3		14	12	26		5
Ambienti	20	5						1	11								3		
Ndërtimi	38	12				2	2	10	6				1				5		
Trafiku	65	9						28	10				2			12	2	2	
Gjithsej	289	53	12	1		2	2	39	78	15			6		14	24	36	2	5

## **DISKUTIMET PUBLIKE**

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

## **TAKIME TË TJERA**

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

## **SFIDAT**

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese,

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

## **REKOMANDIMET**

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.